

V E N D I M
Nr.322, datë 30.6.1993

PËR KRIJIMIN E AGJENCISË SË RISTRUKTURIMIT TË NDËRMARRJEVE

Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Krijimin e Agjencisë së Ristrukturimit të Ndërmarrjeve (ARN) pranë Ministrisë së Industrisë, Burimeve Minerare dhe Energjetike. Agjencia e Ristrukturimit të Ndërmarrjeve do të ketë nën mbikqyrje e ndihmë teknike e ekonomike deri në 30 ndërmarrje shtetërore.

2. Ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore i paraqesin ARN-së propozimet e tyre për ndërmarrjet shtetërore, të cilat do të kalojnë nën mbikqyrje të saj. Çdo propozim duhet shoqëruar me një dosje të plotë, ku të jepen të dhënat për gjendjen ekonomiko-financiare të ndërmarrjes.

ARN, mbi bazën e këtyre propozimeve, i paraqet për miratim Këshillit të Ministrave ndërmarrjet që mund të kalojnë në vartësi të saj.

3. Agjencia e Ristrukturimit të Ndërmarrjeve vendos dhënien e fondeve për investim për blerjen e lëndës së parë etj. për këto ndërmarrje, si dhe kontrollon veprimtarinë e tyre. Përdorimi i fondeve bëhet sipas rregullave të përdorimit të fondeve buxhetore dhe statutit të ARN-së. Kjo e fundit i propozon Këshillit të Ministrave mbylljen ose likuidimin e ndërmarrjeve shtetërore që nuk mund ta vazhdojnë veprimtarinë ekonomiko-financiare, si dhe Agjencisë Kombëtare të Privatizimit privatizimin e pjesshëm ose të plotë të tyre.

4. Për Agjencinë e Ristrukturimit të Ndërmarrjeve parashikohet çdo vit në Buxhetin e Shtetit fondi për rikonstruksionin e ndërmarrjeve. Shpërndarja dhe përdorimi i tij është në kompetencë të Agjencisë së Ristrukturimit të Ndërmarrjeve. Kur vendoset përdorimi i njëhershëm e një shume më të madhe se ekuivalenti i 100.000 USD, merret miratimi i Kryesisë së Këshillit të Ministrave.

5. Agjencia e Ristrukturimit të Ndërmarrjeve, kryesohet nga kryetari i saj, i cili varet nga ministri i Industrisë, Burimeve Minerare dhe Energjetike dhe është në nivel zëvendësministri. Ai emërohet nga Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit të Industrisë, Burimeve Minerare dhe Energjetike.

6. Agjencisë së Ristrukturimit të Ndërmarrjeve, për vitin 1993, i miratohen 3 milionë lekë për fond page dhe shpenzime administrative, që përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave në Buxhetin e Shtetit për vitin 1993.

7. Ngarkohet Ministria e Industrisë, Burimeve Minerare dhe Energjetike të marrë masat e nevojshme për përcaktimin e personelit, të mjeteve e zyrave brendapërbrenda mjediseve të saj.

8. Agjencia e Ristrukturimit të Ndërmarrjeve, brenda muajit gusht të vitit 1993, të paraqitë për miratim në Këshillin e Ministrave statutin e veprimtarisë së saj, si dhe ndryshimet e nevojshme në aktet ligjore e nënligjore të domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë së saj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi